



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**K R Y E T A R I**

---

*Adresa: Rruga "AbdiToptani", nr.1, Tiranë; E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al*

Nr. 671/6 Prot.

Tiranë, më 28.12.2019

**V E N D I M**  
**Nr. 168, Datë 28.12.2019**

**PËR**  
**AUDITIMIN E USHTRUAR NË AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR, PËR**  
**PROJEKTIN "NDËRTIMI I RRUGËS QUKËS-QAFË PLOÇE", "MBI ZBATIMIN E**  
**PËRPUTHSHMËRISË"**  
**për periudhën nga fillimi i projektit deri më datën 31.10.2019.**

Nga auditimi i ushtruar në Autoritetin Rrugor Shqiptar për projektin "Ndërtim i rrugës Qukës-Qafë Ploçe" me objekt "Auditim Përputhshmërie", mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e zbatimit të udhëzuesve të donatorëve për zbatimin e procedurave të prokurimit, realizimin e disbursimeve, zbatimin e kontratave dhe vendimmarrjeve në lidhje me problematikat që dalin gjatë zbatimit të tyre, u konstatuan devijime/shkelje të këtyre udhëzuesve, të rëndësisë materiale për nga natyra për të cilën japim opinion të kualifikuar.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 10, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

**V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi zbatimin e përputhshmërisë" të ushtruar në Autoritetin Rrugor Shqiptar, për Projektin "Ndërtim i rrugës Qukës-Qafë Ploçe", sipas programit të auditimit nr. 671/1 Prot., datë 16.09.2019, për veprimtarinë nga fillimi i Projektit deri më datë 31.10.2019.

**II.** Të miratoj Opinionin e auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

## A. OPINIONI I AUDITIMIT

### **Opinion mbi përputhshmërinë (I kualifikuar)**

Ne kemi audituar përputhshmërinë e aktivitetit të projektit “Ndërtim i rrugës Qukës – Plloçe”, bazuar në Marrëveshjen e Kredisë miratuar me ligjin nr. 128/2013 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Istisna'a dhe të marrëveshjes së agjencisë Istisna'a ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim” dhe ligjin nr. 46/2014 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim”. Auditimi është bazuar në ligjin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit, Manualin e Përputhshmërisë, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik ISSAI 4000<sup>1</sup> dhe 4100.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit, mbi të cilat janë formuluar gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, përmbledhur në bazën për opinion, si rrjedhojë e ekzekutimit të procedurave audituese, rezulton se implementimi i projektit, për shkak të rëndësisë të anomalive të trajtuara në këtë raport, ka devijime materiale por jo të përhapura kjo referuar kërkesave të Marrëveshjeve të Kredisë miratuar nr. 128/2013 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Istisna'a dhe të marrëveshjes së agjencisë Istisna'a ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim” dhe ligjin nr. 46/2014 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim”, si dhe aktet e tjera rregullative në zbatim të këtyre Marrëveshjeve, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e opinionit kualifikuar mbi përputhshmërinë.

### **Baza për Opinionin**

Mbështetur në gjetjet nga auditimi, kemi arritur në konkluzionin se nga strukturat drejtuese të projektit nuk janë marrë hapat e duhur për njoftimin në kohë të pasojave që sjell mos financimi i plotë i projektit, veçanërisht i lotit 3. Janë krijuar vonesa kryesisht në zbatimin e kontratave të punimeve civile, vonesa të cilat kanë rezultuar me vonesë të projektit në tërësi, ndryshimin herë pas here të planit të disbursimeve, si dhe kosto shtesë kryesisht si pasojë e zgjatjes së afatit të kontratave të shërbimeve konsulentë, konkretisht për mbikëqyrjen e punimeve. Nga ana e ARRSH nuk janë marrë masat e duhura për realizimin e prokurimeve për shërbimin e projektimit, pasi projekt-zbatimi ka rezultuar me mangësi të theksuara. Për përmirësimin e projekt-zbatimit është nevojitur vendimmarrja e ARRSH nëpërmjet miratimit të urdhër ndryshimeve, procese të cilat kanë shkaktuar vonesa në realizimin e punimeve civile, si dhe shtesë të koston së projektit. Si pasojë e mos korrektësisë në zbatimin e detyrimeve të ndërsjella kontraktore, kontraktorët kanë paraqitur pretendime si për shtesë në afatet e kontratave, ashtu dhe pretendime për dëme financiare, të cilat përbëjnë risk për rritje të mëtejshme të koston së projektit.

<sup>1</sup> Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje tëveçanta.

Projekti duhet të përfundonte në vitin 2018, ndërkohë që deri në fund të muajit tetor 2019, nuk është realizuar më shumë se 57 % e disbursimeve. Referuar ndryshimeve të miratuara deri në momentin e auditimit dhe ato në proces miratimi, kosto e projektit rritet me vlerë mbi 59 milionë USD, vlerë e cila pritet të rritet deri në përfundim të projektit, duke i kushtuar shumë buxhetit të shtetit në investimet me financime të huaja.

Nga auditimi kanë rezultuar efekte negative financiare me vlerë 582.5 mijë USD, vlerë e cila përbën pagesa për mjete transporti të pa nevojshme, punime të dëmtuara nga rrëshqitjet e skarpateve si dhe dëm ekonomik me vlerë 37.4 mijë USD, i cili rezulton nga pagesa për shërbime të pa realizuara për transport personeli.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga ARRSH, theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e përputhshmërisë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

### **Përgjegjësitë e Drejtimit të Projektit.**

Drejtimi i projektit është përgjegjës për marrjen e masave të nevojshme në drejtim të garantimit të përputhshmërisë së aktivitetit me kushtet e Marrëveshjeve të Kredisë miratuar me ligjin nr. 128/2013 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Istisna'a dhe të marrëveshjes së agjencisë Istisna'a ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim” dhe ligjin nr. 46/2014 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim”. Gjithashtu drejtimi i projektit është përgjegjës kryesor për ngritjen e sistemeve të kontrollit dhe marrjes së masave të sinjalizimit për veprime korruptive në realizimin e objektivave të këtij projekti, duke nisur nga hartimi i rregullave të brendshme, strukturës në dispozicion, duke përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e çdo punonjësi në zbatim të kushteve të Marrëveshjes së Kredisë, mbi të gjitha duke shmangur dhe mbikëqyrur konfliktin e interesit.

### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë.**

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse realizimi i projektit nuk paraqet anomali materiale, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi përputhshmërinë e aktivitetit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi (marrëveshjet e kredisë).

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtimet dhe konsiderohen si

materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar. Përveç standardeve të ISSAI, në gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të projektit. Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë në lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën.

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në marrëveshjen e ratifikuar për projektin e rrugës Qukës - Qafë e Plloçë, nuk është identifikuar konkretisht objektivi i përgjithshëm por janë identifikuar katër objektivat specifike të projektit si më poshtë:

- Sigurimi i lidhjes rrugore më të shkurtër të mundshme me fshatrat e izoluar jugore, kufijtë e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (FYROM) dhe Greqisë e Evropës me Ballkanin e brendshëm;
- shkurtimi i kohës së udhëtimit, kostos së operimit të automjeteve dhe rritja e rehatisë, sigurisë dhe besueshmërisë;
- përmbushja e kërkesave të tashme dhe të ardhme të transportit duke përfunduar Korridorin 8.
- të ndihmojë përshpejtimin e aktiviteteve ekonomike, duke përmirësuar aksesin e njerëzve në pikat turistike, mjediset shoqërore, bizneset dhe mundësitë e punësimit që rrjedhin nga ndërlidhja e shtuar e brendshme dhe rajonale.

Objektivat si më sipër të përcaktuara në marrëveshjen e ratifikuar me ligjin nr. 128/2013 nuk janë objektiva konkrete dhe të matshme. Kjo pasi nuk ka të dhëna të përcaktuara të kohës së shkurtuar me përfundimin e aksit të ri rrugor, nuk ka të dhëna krahasimore të kostos së operimit të automjeteve dhe të dhënave të sigurisë, duke e bërë të vështirë matjen e objektivave të përcaktuara në rast se punimet do të kishin përfunduar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 16-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1 -Rekomandimi:** -ARRSHtë marrë masa që për projektet që hartohen në të ardhmen të përcaktohen objektiva të qarta dhe të matshme, me synim monitorimin e saktë të përfitimeve që arrihen nga zbatimi i tyre.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Referuar kushteve të përcaktuara në marrëveshje, si për realizimin e prokurimeve, ashtu dhe zbatimin e kontratave, ndërtimi i rrugës Qukës-Qafë e Plloçës duhet të kishte përfunduar. Konkretisht Punimet civile për lotin 1 duhet të kishin përfunduar brenda datës 23.06.2018, por afati është shtyrë deri në datë 30.04.2020. Për lotin 2, punimet duhet të kishin përfunduar në 30.06.2018, por afati është shtyrë deri në 31.03.2020, dukë sjellë si pasojë shtyrjen në kohë të arritjes së objektivave dhe përfitimeve nga zbatimi i këtij projekti. Nevoja për shtyrjen e afateve ka ardhur si rezultat i problematikave që lidhen kryesisht me pasaktësitë dhe mangësitë e projektit origjinal, vonesa prej çështjeve mjedisore të ngritura nga Ministria e

Mjedisit si dhe mungesa e financimit për lot 3, veprim i cili jep ndikim negativ për të gjithë projektin(*Më hollësisht trajtuar në pikën5, faqe 37-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1- Rekomandim:-** ARRSH të marrë masa që për projektet në proces dhe projekte që do të financohen të zbatohen me korrektësi detyrimet kontraktore, duke zgjidhur praktikisht çështjet që kanë të bëjnë me shpronësimin për interes publik, ndikimin në mjedis duke paracaktuar karrierat e marrjes së inertëve, si dhe problematika të cilat kanë lidhje me administrimin e pushtetit vendor etj., me synim minimizimin e riskut të vonësive, të cilat shoqërohen me mos arritjen e objektivave dhe kosto shtesë për Projektin.

### *Vazhdimisht*

**3. Gjetje nga auditimi:** Projekt-zbatimi origjinal për të trelotet është hartuar nga kompania “A.P.R.”, në periudhën 2009-2010, i cili ka rezultuar me mangësi të theksuara të cilat, konsistojnë në:

- Trupi i rrugës sipas projektit origjinal është dhënë kudo i njëjtë, duke mos llogaritur zgjerimet e nevojshme të rrugës, kryqëzimet, vend parkimet, sistemet e kullimit dhe drenazhet, si dhe përforcimin e trupit të rrugës. Paketa e shtresave rrugore është projektuar uniformë, pavarësisht formacioneve gjeologjike-gjeoteknike, kur rruga është në gjermim apo mbushje.
- Vizatimet nuk përputhen me udhëzimet e raportit gjeoteknik, përse i takon kategorisë së gjermimeve të shpateve, si dhe nuk është parashikuar ndërtimi i mureve gabione si masë mbrojtëse për parandalimin e rrëshqitjeve.
- Mungojnë vizatimet/planimetria e rrugës, profili gjatësor, si dhe nuk janë projektuar dhe parashikuar rrugët lidhëse me fshatrat.
- Në projektin origjinal nuk ka asnjë të dhënë mbi zhvendosjen e linjave elektrike, apo sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimet.
- Muret mbajtëse janë parashikuar mbi 15 m, të cilat ose janë jo fizibël, ose është e pamundur për ndërtim etj.
- Mungesë e vizatimeve në projekt, llogaritje të gabuara konstruktive si dhe mungesë e studimit gjeologjik/gjeoteknik, për urat nr. 4, nr. 10 dhe nr. 11.
- Diferenca të volumeve të paraqitura në projekt dhe preventiv, krahasuar me faktin në terren.
- Mangësitë e projekt-zbatimit kanë prodhuar pasoja negative gjatë zbatimit të cilat kanë të bëjnë me rritje të koston, zgjatje të afatit të përfundimit të projektit dhe rrjedhimisht të arritjes së objektivave. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Kushtet Teknike të Projektimit (*Më hollësisht trajtuar në pikën5, faqe 37-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1-Rekomandimi:-**Nga ana e Ministrisë së linjës dhe ARRSH të verifikohet, shqyrtohet dhe të nxirren përgjegjësitë për hartuesit, monitoruesit dhe pranuesit e projektit të zbatimit për këtë projekt, duke marrë masat përkatëse sipas dispozitave ligjore.

**3.2- Rekomandimi:-**ARRSH të marrë masa për monitorimin me korrektësi të hartimit të projekteve të zbatimit për projekte në vijimësi, në mënyrë që të shmangen kostot që vijnë nga përgatitja e projekteve me mangësi, të cilat shkaktojnë kosto shtesë në realizimin e projekteve.

### *Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:-**Kontrata e punimeve civile për Lot 1, ishte parashikuar të përfundojë për një periudhë 1096 ditësh, ose me datë 23.06.2018, porafati i zbatimit të kontratës është shtyrë me 365 ditë, referuar amendamentit nr. 1 të kontratës, me datë përfundimi 30.06.2019. Nga auditimi rezulton se gjatë zbatimit të kontratës janë shkaktuar vonesa të cilat dalin përtej

përgjegjësi të kontraktorit, të cilat kanë ardhur kryesisht për mos caktimin nga ana e Bashkisë Pogradec të vend depozitimit të dherave; për arsye të vonesave në procesin e shpronësimit për interes publik; të ndryshimeve të rëndësishme nga projekti origjinal i cili ka realizuar me mangësi të theksuara, si dhe për arsye të pezullimit të punimeve për mos miratim të barrierave të marrjes së materialeve për mbushje etj.

PMU me shkresë nr. 1240/2 prot., datë 13.08.2019, ka njoftuar kontraktorin për dështim në përmbushje të nenit 8.2 të Kontratës “Koha për përfundim”, për mos përfundim të punimeve sipas Urdhër Ndryshimit nr. 1. Sa më sipër i është kërkuar Mbikëqyrësit të Punimeve të vendosë në përputhje me pikën 3.5 të kushteve të Përgjithshme të kontratës, për ngjarjet në vazhdimësi.

Pavarësisht këtij njoftimi, nga ana e PMU dhe Mbikëqyrësit të Punimeve nuk janë marrë masa të mëtejshme, për reflektimin e shkaqeve si dhe kohës së vonesës në përgjegjësinë e Kontraktorit, por edhe shqyrtimin e pretendimeve të tij, pavarësisht se Kontrata nuk është përfunduar. Ky veprim është në mos përmbushje të Pikës 8.5, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 37-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1-Rekomandimi**:- Njësia e Menaxhimit të Projektit, në bashkëpunim me Mbikëqyrësin e Punimeve të marrin masa për përgatitjen e dokumentacionit me detaje në lidhje me vonesat e shkaktuara nga ana e Kontraktorit në realizimin e punimeve, si dhe përllogaritjen e penalteteve për vonesa në përgjegjësinë e tij.

*Brenda datës 31.03.2020*

**5. Gjetje nga auditimi:** Janë bërë disa ndryshime të kontratave të punimeve civile për shkak të rishikimit të projekt-zbatimit origjinal, ashtu edhe sa i takon afateve të përfundimit të punimeve:

-Për lot 1, janë realizuar 2 shtesa kontrate, janë miratuar 2 urdhër ndryshimi dhe janë në proces 2 urdhër ndryshimi të tjerë. Vlera e kontratës për lot 1, parashikohet të bëhet rreth 60.7 milionë USD, me një shtesë referuar kontratës bazë me vlerë rreth 22.6 milionë USD, ose 59 % më e lartë se parashikimi;

-Për Lot 2, janë miratuar 4 shtesa kontrate, janë miratuar 3 urdhër ndryshime dhe janë në proces miratimi 4 urdhër ndryshimi. Duke marrë në konsideratë urdhër ndryshimet e miratuara, por edhe ato të pamiratuara akoma, pritet që vlera e kontratës të bëhet rreth 89.3 milionë USD, me një shtesë referuar kontratës bazë me vlerë rreth 26 milionë USD, ose 41.2 % më e lartë. Ndryshimet e kontratave janë realizuar kryesisht nga domosdoshmëria e përmirësimit të projekt-zbatimit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 37-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1 - Rekomandime**:- Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Njësia e Menaxhimit të Projektit, në bashkëpunim me Mbikëqyrësin e Punimeve të marrin masa për miratimin e urdhër ndryshimeve të cilat janë në proces miratimi, duke mbajtur në konsideratë ekonomikitetin, eficiencën dhe efektivitetin, pa cenuar standardet e miratuara dhe cilësinë e punimeve dhe afatin e përfundimit.

*Brenda datës 31.03.2020.*

**6. Gjetje nga auditimi:** - Për kontratën Lot 1, deri në periudhën e auditimit janë likuiduar 7 certifikata pagese, nga të cilat Certifikata e ndërmjetme nr. 7, është hartuar nga Kontraktori dhe certifikuar nga mbikëqyrësi me vlerë 4,242,360.6 USD. Kjo certifikatë pagese është rishikuar

nga Drejtori aktual i PMU, ku sasitë për disa zëra punimesh janë reduktuar. Vlera e pagesës sipas certifikatës së rishikuar është 3,120,971.6 USD, pra me një zbritje me vlerë 1,121,389 USD. Zërat e punimeve për të cilat janë rishikuar volumet paraqiten si më poshtë:

- Shërbimin e automjeteve në disponim të mbikëqyrësit të punimeve, pagesë për drejtues mjeti, pagesë për punonjës laborator.

- Terramesh (tokë e përforcuar), gjurmime në skarpata, punime drenazhimi, punime gjurmimi dhe furnizim vendosje beton arme, etj.

Për kontratën Lot 2, deri në periudhën e auditimit janë likuiduar 22 certifikata pagese. Kontraktori ka paraqitur certifikatën nr. 21 me vlerë 1,406,740.4, e cila është miratuar edhe nga mbikëqyrësi i punimeve, por volumet për disa zëra punimesh janë rishikuar nga Drejtori i aktual i PMU, duke zbritur vlerën 660,494.8 USD. Punimet e zbritura sipas certifikatës nr. 21, kanë të bëjnë me punimet në tunele, në lidhje me transport dherash në vendin e përcaktuar nga pushteti vendor deri 5 km dhe punime gjurmim tuneli me kontroll vibrimi për sasinë 45077 m<sup>3</sup> certifikuar me çmim 40 USD/m<sup>3</sup>, e cila është rishikuar sipas zërit gjurmim për harkun e tunelit me çmim 30 USD/m<sup>3</sup>). Sa i takon certifikatën nr. 22, miratuar me datë 14.10.2019, janë certifikuar punime me vlerë 7,608,000 USD. Në total, deri në momentin e auditimit për këtë kontratë janë certifikuar punime me vlerë 50,405,893.5 USD.

Pavarësisht se vlera 660,494.8 USD nuk është likuiduar, në certifikatën nr. 22, kemi të bëjmë me certifikim në total të volumeve. Certifikimi i punimeve me mangësitë e mësipërme është në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Pika 14.3 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 37-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1 -Rekomandimi:** - Njësia e Menaxhimit të Projektit në bashkëpunim me Mbikëqyrësin e Punimeve të marrin masa për monitorimin dhe certifikimin e punimeve në përputhje me përcaktimet kontraktore, për të shmangur problematika serioze, sidomos në raste të dështimit të përmbushjes së detyrimeve dhe të drejtave që palët kanë të përcaktuar në kontratë, si dhe uljes së mundësisë së paraqitjes së pretendimeve nga ana e kontraktorëve.

*Vazhdimisht*

**7. Gjetje nga auditimi:-** Gjatë zbatimit të kontratës lot 1 dhe lot 2, kontraktorët kanë paraqitur pretendime të cilat kanë të bëjnë me mos zbatimin e detyrimeve të punëdhënësit si më poshtë:

(a) Për lot 1:

- Mungesën e zërit Furnizim-Vendosje armaturë (kallëpe). Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, ky pretendim është konsideruar i refuzuar, pasi ky zë punimi konsiderohet i përfshirë në zërat e tjerë të punimeve.

- Kërkesë për kohë shtesë për vonesa jo në përgjegjësinë e Kontraktorit. Ky pretendim është konsideruar i drejtë dhe Kontraktorit i është miratuar një shtesë me afat 12 mujor.

- Pretendim për një kohë të dytë shtesë dhe kosto financiare me vlerë 200,430 USD, rezultat nga vonesat. Sipas vlerësimi të Supervizorit, duke marrë në konsideratë të gjitha vonesat, kryesisht e ardhur nga vonesa në miratimin e urdhër ndryshimit nr. 2, të cilat nuk janë në përgjegjësi të Kontraktorit, duhet të aprovohet një shtesë me afat 283 ditësh, me datë përfundimi 06.04.2020, me kushtin që kjo zgjatje në kohë sipas dakordësisë së palëve, nuk do të reflektojë kosto të tjera shtesë.

- Kontraktori ka paraqitur pretendim për dëm të shkaktuar ndaj tij, si pasojë e vonesës për një periudhë 9 muaj e 10 ditë, me vlerë rreth 11.7 milionë USD. Nga ana e Supervizorit është vlerësuar se kontraktori nuk ka të drejtë mbi pretendimin.

- Kohë shtesë dhe kosto financiare për arsye të vonesës në likuidimin e certifikatës IPC 7 dhe IPC 8 (IPC 8, është në proces vlerësimi). Nga vlerësimi i Supervizorit rezulton se kontraktori nuk ka të drejtë mbi pretendimin, pasi volumet e IPC janë korrigjuar në përputhje me Pikën 14.6 të kushteve të Përgjithshme të Kontratës.

(b) Për lot 2.

- Në mars 2018, kontraktori ka paraqitur pretendim për kohë shtesë në përfundimin e punimeve. Nga vlerësimi i Supervizorit Kontraktori ka të drejtë për një shtesë prej 15 muajsh, të afatit të përfundimit të punimeve, për vonesa të shkaktuara jo në përgjegjësinë e tij.

- Pretendimin mbi diferencën e çmimit njësi për zërat e punimeve dhe i përforcuar (terramesh). Nga vlerësimi i Supervizorit pretendimi konsiderohet i drejtë, por është kërkuar që nga ana e Kontraktorit të paraqiten të gjithë sasitë për zërat përkatës të punimeve.

- Kosto shtesë gjatë shpimit të pilotave për urën 10 dhe 11. Ky pretendim është bërë i pavlefshëm, me ndryshimet që i janë bërë projektit.

- Kosto shtesë për dëme të shkaktuara si pasojë e kushteve fizike të paparashikuara në kilometër 28+600 deri kilometër 29+150, si pasojë e rrëshqitjeve të datës 07.03.2018. Ky pretendim nuk është pranuar nga ana e Supervizorit, pasi ai është paraqitur jashtë periudhës 28 ditore nga ndodhja e ngjarjes, e përcaktuar në kushtet e kontratës Pika 4.10 dhe 20.1.

- Kosto shtesë për shkak të vonesave në dhënie e instruksioneve për realizimin e projektit për mbrojtjen dhe stabilizimin e skarpateve. Ky pretendim nuk është vlerësuar në thelb, për arsye të mosdakordësive mes Supervizorit dhe Kontraktorit lidhur me adresën dhe datën e dërgimit.

- Kosto shtesë për shkak të vonesave të në pagesën e IPC 18 dhe 19.

- Kosto shtesë për shkak të vonesave të në pagesën e IPC 21. Nga ana e Supervizorit është vlerësuar se dy pretendimet e mësipërme nuk kanë baza kontraktuale.

- Kosto shtesë për shkak të vonesave të në pagesën e IPC 22. Ky pretendim është në proces vlerësimi (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 37-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**7.1 -Rekomandimi:-** Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Mbikëqyrësi i Punimeve për lot 1 dhe 2, duhet të zbatojnë me korrektësi detyrimet kontraktore në lidhje me shqyrtimin e dokumentacionit të pretendimeve të kontraktorëve, duke kërkuar edhe mendimin e Bordit të Diskutimeve, në rastet e mospranimeve nga ana e tyre.

*Vazhdimisht*

**8. Gjetje nga auditimi:** - Nga verifikimi i punimeve të realizuara në objekt për lot 1, rezulton se një segment me gjatësi rreth 5 km nuk kanë filluar akoma punimet e ndërtimit të rrugës. Në disa segmente punimet janë kryer me ndërprerje, për arsye të mungesës së rrugëve të aksesit.

Mos bërja e mundur e fillimit të punimeve në zonat e rrëshqitshme, për arsye të vonesës në dhënie zgjidhjeve teknike, ka bërë të domosdoshme hapjen e rrugëve të aksesit në gjatësi mbi parashikimin. Ndërtimi i këtyre rrugëve, krahas rritjes së kostove të projektit, sjell ndikim negativ në mjedis (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 37-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**8.1-Rekomandimi:** - Njësia e Menaxhimit të Projektit, në bashkëpunim me Mbikëqyrësin e Punimeve të marrin masa për zbatimin me korrektësi të përcaktuara kontraktore në lidhje me monitorimin e zbatimit të kushteve të sigurisë gjatë zbatimit të punimeve, në mënyrë që të shmangen aksidentet në punë dhe për përdoruesit e rrugës.

*Vazhdimisht*



**9. Gjetje nga auditimi:** Punimet për lot 2, kanë filluar me datë 01.07.2015 dhe janë parashikuar të përfundojnë me datë 30.06.2018.

Kontraktori ka rishikuar programin e zbatimit të punimeve pas aprovimit të Urdhër Ndryshimit nr. 1, me datë 23.07.2015. Programi i rishikuar nr. 3, është paraqitur në nëntor 2016, pas kërkesës për rishikimin e afatit të përfundimit. Programi është rishikuar pas shtesës së afatit në janar 2017. Kontraktori ka paraqitur pretendim për shtesë të afatit të përfundimit të punimeve në qershor 2017 dhe është aprovuar në muajin mars 2018. Kontraktori ka paraqitur programin e rishikuar nr. 5 sipas shkresës nr. A-199, datë 25.05.2018, i cili është në vlerësim nga ana e Mbikëqyrësit të Punimeve, ku përfshihet edhe realizimi i punimeve elektromekanike për tunelet deri në muajin janar 2020. Sipas urdhër ndryshimit nr. 3, afati i përfundimit të punimeve është shtyrë për datë 31.03.2020.

Sa më sipër konstatohet se, si pasojë e projektit origjinal hartuar me mangësi por edhe probleme të tjera, afati i përfundimit të punimeve është shtyrë për një periudhë 9 mujore, duke mos mundur të vënien e segmentit rrugor në eficiencë në periudhën e caktuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 37-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**9.1- Rekomandimi:** - Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Mbikëqyrësi i Punimeve të marrin masa për shqyrtimin, miratimin dhe përcjelljen në kohë për vendimmarrje pranë Këshillit Teknik të dokumentacionit përkatës të zgjidhjeve teknike pa shkaktuar vonesa, në mënyrë që të shmangen rritjet e kostove të projektit dhe dhënien e mundësisë kontraktorëve për të paraqitur pretendime të cilat krahas kërkesave për shtyrje afati, shoqërohen edhe me kërkesa për dëmshpërblim.

*Vazhdimisht*

**10. Gjetje nga auditimi:** Bazuar në ligjin nr. 46/2014 "Për ratifikimin e Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për Financimin e Projektit të Ndërtimit të rrugës Tiranë - Elbasan - Qukës - Qafë e Pllaçës, për lotin 3", nga Fondi Saudit për Zhvillim për projektin e sipërcituar është akorduar vlera 25 milion USD. Shuma e kërkuar për përfundimin e Lot 3 është 50 milionë USD, fakt që është paraqitur dhe pasqyruar disa herë nga kërkesat e ARRSH (Njësia e Zbatimit të Projektit) drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe Ministrisë së Financave, rreziku që sjell mos financimi i Lotit 3 për gjithë projektin.

Nga grupi i auditimit konstatohet se aktualisht nuk ka një përgjigje nga Ministria e Financës dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me financimet shtesë për Lotin 3, që kërkohen nga ARRSH, Njësia e Menaxhimit të Projektit për mbarëvajtjen e projektit sepse aktualisht punimet për përfundimin e Lotit 3 janë ndërprerë sepse nuk ka më financim, duke rrezikuar kështu përfundimin me sukses të Lotit nr.3 dhe gjithë projektin e ndërtimit të rrugës Tiranë - Elbasan - Qukës - Qafë e Pllaçës-

Fondet në dispozicion për kontratë Lot 3, janë me vlerë 25 milionë USD. Mungesa e financimit dhe rrjedhimisht, pezullimi dhe ndërprerja e realizimit të punimeve do të sjellë pasoja si financiare ashtu dhe teknike të cilat kanë të bëjnë me:

- Vonesë e vënies në funksionim të plotë të rrugës, pasi ndërtimi i lotit 1 dhe 2, nuk do të jetë efektiv pa vënien në funksionim të lot 3, pasi lot 3 është vazhdim i dy loteve të mëparshme, pra investimi për ndërtimin e rrugës nuk do të bëhet eficient për një periudhë të caktuar duke mos arritur përfitimet e parashikuara të projektit.

- Degradim i punimeve të realizuara si rrëshqitje të skarpave, dëmtim të shtresave rrugore, dëmtim të tokës së përforcuar si pasojë e filtrimit të ujërave në tabanin e rrugës, për të cilat do

të kërkohen punime dhe fonde shtesë, pa marrë në konsideratë shtesat e fondeve për arsye të tjera si mangësitë në projektin origjinal.

- Pezullimi i punimeve për arsye të mungesës së financimit është përgjegjësi e punëdhënësit dhe në këto kushte mos plotësimi i detyrimeve kontraktore, mund të shoqërohet me penalitete, të cilat do të rrisin më tej kostot e projektit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1 dhe 5, faqe 37-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**10.1- Rekomandimi:** - ARRSH dhe Njësitë e Menaxhimit të Projektit në rakordim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe Ministrinë e Financave, të marrin masa për sigurimin e fondeve, për shmangien e ndërprerjessë kontratave të punimeve civile dhe projektit në tërësi.

*Brenda datës 31.03.2020*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi në terren për lot 3, rezultoi se pjesa më e madhe e materialit shkëmbor i cili del nga gërmimet e skarpateve është i papërdorshëm pasi copëzohet dhe shkrihet në prezencë të agjentëve atmosferik. Ky fenomen do të krijojë probleme serioze edhe në lartësinë e skarpateve, pasi do të krijohen fenomene të rrëshqitjes së tyre, sidomos për faktin se për këto skarpate nuk është parashikuar asnjë fenomen mbrojtjeje për rrëshqitje të tyre.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 37-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**11.1 - Rekomandimi:** - Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Mbikëqyrësi i Punimeve të marrin masa për përcaktimin e barrierave për marrjen e inertëve të nevojshme për realizimin e nënshtrësave rrugore, pa rritur koston e punimeve civile.

**12.1 - Rekomandimi:** Të merren masa për parashikimin e masave mbrojtëse për skarpatat nga rrëshqitjet me synim shmangien e dëmtimeve të tyre si dhe mbrojtjen e përdoruesve të rrugës nga aksidentet si pasojë e rënies së shkëmbinjve nga lartësitë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit për përzgjedhjen e konsulentit për lotin I dhe II për ndërtimin e segmentit rrugorë “ Qukës – Qaf Pllaçë” me operatoreve fitues C.E.C u konstatua se nga ana e komisionit për vlerësimin e ofertave, për operatorin (CID) edhe pse është vlerësuar maksimalisht në eksperiencën të ngjashme dhe në një vlerësim shumë të lartë në stafin përbërës, për sa i përket pikës (teknika dhe metodologjia) është vlerësuar mjaft ulët duke marrë në konsideratë eksperiencat e ngjashme dhe stafin elementar që ka sjellë dhe mos shpalljen fitues të kësaj procedure nga ky operator, i cili është paraqitur dhe me ofertë me eficientë. Nga ana e komisionit, duhet të shqyrtohet me korrektësi fakti se metodologjia në mbikëqyrjen e punimeve është një element më pak i rëndësishëm, pasi detyrimet në mbikëqyrje sanksionohen në kontratat dhe udhëzuesit përkatës (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 29-37 Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**12.1-Rekomandimi:-** Komisioni i ngritur për vlerësimin e ofertave në të ardhmen të vlerësojë me korrektësi dhe me integritet dokumentacionin tekniko-ekonomik të operatorëve për të përfituar një vlerësim të saktë, për të arritur eficientë maksimale në përzgjedhjen e operatorëve fitues në procedurat e prokurimit.

*Vazhdimisht*

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga ndryshimet e kërkuara dhe miratuara në projektin fillestar si dhe miratimi i shtyrjes së afatit kohor të përfundimit të veprës, ka sjellë si domosdoshmëri shtyrjen

e afatit të kontratave të shërbimeve konsulente. Deri në momentin e auditimit janë miratuar shtesa në afate por edhe financiare të cilat për lot 1 dhe lot 2, kapin vlerën e 1 milionë USD si dhe për lot 3 me vlerë 2.1 milionë USD. Duke marrë në konsideratë faktin se kontratat janë në proces, shpenzimet konsulente do të pësojnë rritje të mëtejshme(*Më hollësisht trajtuar në pikën3, faqe 22-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13.1-Rekomandimi**:-Njësitë e Menaxhimit të Projektit të marrin masa që të reduktojnë në maksimum stafin e konsulentit duke mbajtur vetëm ato që janë të domosdoshëm për ndjekjen e punimeve si dhe të marrin masa për arritjen e marrëveshjeve me mirëkuptim për pezullimin e kontratave të mbikëqyrjes së punimeve sidomos për lot 3, deri në momentin e rifillimit të punimeve.

#### *Gjatë zbatimit të projektit*

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i disbursimeve financiare të projektit u konstatua se, realizimi i tyre në afatet kohore nuk është respektuar duke i tejkaluar ato në dyfishin e kohës së parashikuar në marrëveshjen e financimit, kjo si rrjedhojë e vonesave në realizimin e punimeve nga faktorët teknik “Problematika në projektin e zbatimit” si dhe në faktorët natyrorë. Projekti cili kafillohet në 21 Janar 2016 dhe afat përfundimi Dhjetor 2018. Pas një ndërprerje të punimeve në Janar 2017, për shkak të temperaturave të ulëta dhe ngricave, që prej 15 Marsit 2017 punimet kanë rifilluar. Deri në fund të Gushtit 2018 treguesit e performancës kanë qenë realizimi fizik 33 %, realizimi kohor 65 % dhe realizimi financiar 13 %. Nga grupi i auditimit konstatohet se aktualisht nuk ka një përgjigje nga Ministria e Financës dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me financimet shtesë për Lotin 3, që kërkohen nga ARRSH, Njësia e Menaxhimit të Projektit për mbarëvajtjen e projektit sepse aktualisht punimet për përfundimin e Lotit 3 janë ndërprerë sepse nuk ka më financim, duke rrezikuar kështu përfundimin me sukses të Lotit nr. 3 dhe gjithë projektit(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 16-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**14.1- Rekomandimi**: - Njësitë e Menaxhimit të Projektit të marrin masa për realizimin e disbursimeve sipas planit si dhe të kërkohet nga donatorët ndryshimet e duhura kur ecuria e projektit nuk është në nivelin e parashikuar.

#### *Vazhdimisht*

### **C.1 MASA SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga auditimi-** Në raportin shkurt 2017 (Për lot 2), pika 8.4 “Facilitetet e Konsulentit”, përcaktohet: “Deri në këtë periudhë kontraktori ka siguruar “1 automjete tip A, 1 automjet tip B dhe 1 automjet tip C”. Kontraktori duhet të blejë edhe dy automjete Tip A, viti 2015. Rezulton se deri në këtë datë nuk janë furnizuar dy automjete. Nga lidhja e kontratës deri me datë 31.12.2018 janë përfshirë për pagesë:

Tip A - 36 muaj x 3 automjete = 108 muaj

Tip B - 35 muaj x 1 automjet = 35 muaj

Tip C - 23 muaj x 1 automjet = 23 muaj

Sa më sipër, bazuar në periudhën e aktivitetit deri në muajin qershor 2017 (18 muaj), rezulton se pavarësisht se nuk janë siguruar mjetet, pagesat për shërbim të tyre sipas zërit j Zërit 1.2.7.a “Kosto e drejtimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve për inxhinierin dhe stafin e tij” është likuiduar për 108 muaj. Pagesa për këtë shërbim duhet të realizohet vetëm pas furnizimit të automjeteve, pra për një periudhë 72 muaj.

Sa më sipër, pagesa me vlerë 21,600 USD [(18 muaj x 2 mjete x 500 USD/muaj) + TVSH], është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.

- Sa i takon zyrave për konsulentin, kontraktori është likuiduar në masën 50 %, ose 10,000 Euro, ndërsa sipas zërit 1.2.8 “Pastrim dhe mirëmbajtje zyrash, kosto e laboratorit” është likuiduar me vlerë 32,800 USD (41 muaj x 800 USD/muaj). Duke marrë në konsideratë faktin se nga ana e kontraktorit nuk është furnizuar laborator (nuk ishte parashikuar ndërtimi i një laboratorit), si dhe faktin se zyrat janë vënë në dispozicion të Mbikëqyrësit të Punimeve në muajin shkurt 2017 (12 muaj me vonesë), vlera 11,520 USD [12 muaj x 800 USD/muaj) + TVSH], është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.

Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me specifikimet teknike Pika 1.31 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 37-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1 - Rekomandimi:** - Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Mbikëqyrësi i Punimeve të marrin masa për reduktimin e vlerës **33,120 USD**, në certifikatat ndërmjetëse të pagesave të Kontraktorit “**C.G.C.G C0. (Kuwait) &A.BSh.p.k**”, duke e reflektuar këtë reduktim deri në përfundim të kontratës.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** - Gjatë auditimit për Lot 2, u verifikuan disa zëra të punimeve të realizuara në objekt. Nga verifikimi rezultojnë se:

- Në përgjithësi, për muret mbajtës të ndërtuar nuk ka filluar mbushja me materialin e përcaktuar në specifikimet teknike dhe si pasojë mbushja pas tyre plotësohet nga rënia e dherave nga shpatet.

Në kilometër 22+718 pas murit nuk është mbushur me çakëll, por material i rënë nga shpati, veprim në kundërshtim me specifikimet teknike. Si rezultat, nuk realizohet drenazhimi i ujërave të formacionit, duke vënë në rrezik qëndrueshmërinë e murit, si dhe të vetë segmentit të rrugës në të cilin shtrihet. Sasia e mbushjes në sasinë afërsisht 300 m<sup>3</sup> konsiderohet e pa realizuar. Ky veprim është në kundërshtim me Specifikimet Teknike të Kontratës. Vlera 4,320 USD [(300 m<sup>3</sup> x 12 USD/m<sup>3</sup>) + TVSH], është përfituar padrejtësisht nga kontraktori dhe përbën dëm ekonomik (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 37-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1 - Rekomandimi:** - Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Mbikëqyrësi i Punimeve të marrin masa për reduktimin e vlerës **4,320 USD**, në certifikatat ndërmjetëse të pagesave të Kontraktorit “**C.G.C.G C0. (Kuwait) &A.BSh.p.k**”, duke e reflektuar këtë reduktim deri në përfundim të kontratës.

*Menjëherë*

## **C. 2 MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE TË PROJEKTIT.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Përveç punimeve të cilat nevojiten të realizohen për Lot 2, si pasojë e shtesës në afatin e përfundimit të punimeve nevojiten edhe shpenzime të tjera të cilat nuk rrisin efektivitetin e punimeve, por janë të domosdoshme për ecurinë e kontratës. Deri në periudhën e auditimit, janë likuiduar shpenzime shtesë për sigurime, kosto e operimit të automjeteve në

disponim të mbikëqyrësit të punimeve, kosto laboratorit dhe pagesa për drejtues mjete me **vlërë 363,541 USD, vlerë e cila përbën efekt negativ financiar.**

Për kontratën Lot 2, janë në proces shqyrtimi urdhër ndryshimet si më poshtë:

Urdhër ndryshimi nr. 4, i cili ka të bëjë me vizatimin e urave, me vlerë të parashikuar 2,626,531.8 USD.

Urdhër ndryshimi nr. 5, me vlerë paraprake 3 milionë USD, i cili ka të bëjë me masat për tre zona rrëshqitje.

Urdhër ndryshimi nr. 6, me vlerë paraprake 7.6 milionë USD, i cili ka të bëjë me mbrojtje dhe stabilizim skarpatah.

Urdhër ndryshimi nr. 7, me vlerë paraprake 2.5 milionë USD, i cili ka të bëjë me furnizime pajisje rrugore, shenja sinjalistike, gurë kilometrikë etj.

Duke marrë në konsideratë urdhër ndryshimet e miratuara, por edhe ato të miratuara, pritet që vlera e kontratës të bëhet rreth 89.3 milionë USD, me një shtesë referuar kontratës bazë me vlerë rreth 26 milionë USD, ose 41.2 % më e lartë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 37-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1-Rekomandimi:-** Autoriteti rrugor Shqiptar dhe Njësia e Menaxhimit të Projektit, në bashkëpunim me Mbikëqyrësin e Punimeve të marrin masa për miratimin e urdhër ndryshimeve të cilat janë në proces miratimi, duke mbajtur në konsideratë ekonomicitetin, eficiencën dhe efektivitetin, pa cenuar standardet e miratuara dhe cilësinë e punimeve.

*Vazhdimisht*

**2. Gjetje nga auditimi:-** Në lot 2, ngakilometër 26 deri kilometër 29 rruga ka pësuar rrëshqitje. Projekti origjinal nuk përmban studime të mirëfillta gjeologjike, për projektimin e seksioneve të veçanta të rrugës, të cilat shtrihen në territore me rrezikshmëri rrëshqitje të shpateve, për parashikimin e masave shtesë për ndërtimin e rrugës me qëndrueshmëri. Për vazhdimin e punimeve kërkohet rishikimi i projektit dhe marrja e masave për mbrojtjen e skarpatave dhe trupit të rrugës nga dëmtimi. Në një distancë rreth 300 m, trupi i rrugës është zhvendosur plotësisht duke bërë të papërdorshme edhe punimet e realizuara më parë për ndërtimin e murit mbajtës me gjatësi 150 m, shtresave rrugore, gërmimet etj. **Nga përlogaritje të përafërta, vlera e punimeve të cilat janë realizuar dhe janë dëmtuar arrin në shumën 76 mijë USD, vlerë e cila përbën rritje të koston së projektit.**

- Nga verifikimi i mureve mbajtës prej gabioni rezulton se kokat e murit me shtresë betoni nuk janë realizuar sipas specifikimeve. Ato janë dëmtuar gjatë procesit të heqjes së armaturave.

- Nga verifikimet rezulton se nga ana e Kontraktorit nuk plotësohen në shkallën e duhur masat e sigurisë, për pajisje me sinjalistikë rrugore provizore etj. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 37-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1 - Rekomandimi:** - Nga ana e Njesisë së menaxhimit të Projektit dhe Mbikëqyrësit të Punimeve të merren masa për analizimin e shkaqeve, duke marrë masa paraprake për segmentet e rezultuara me rrëshqitje, për parandalimin e dëmtimeve të mundshme si gjatë zbatimit të kontratës, ashtu edhe pas dorëzimit të punimeve.

*Brenda datës 31.03.2020*

**3. Gjetje nga auditimi:** Në preventivin e punimeve, sipas projektzbatimit origjinal për Lot 3, sipas zërit 2.2 “Shërbime për stafin e inxhinierit” është parashikuar furnizimi i 12 automjeteve në shërbim të mbikëqyrësit të punimeve dhe PMU. Duke marrë në konsideratë faktin se për lot 1 dhe lot 2, është parashikuar furnizimi i 5 automjeteve (kontrata të cilat kanë ngjashmëri dhe

volume punimesh thuajse të njëjta), rezulton se për këtë kontratë numri i tyre është mbi nevojat për këtë shërbim. Nisur nga fakti se kontrata e mbikëqyrjes së punimeve është pezulluar për faktin e mos financimit të punimeve, mbajtja e tyre në përdorim të mbikëqyrësit të punimeve do të rrisë kostot e projektit për shërbime të pa nevojshme. Po ashtu, bazuar në specifikimet teknike, duke qenë se këto mjete në përfundim të kontratës do të kalojnë si asete pranë ARRSH, me kalimin e kohës ato do të amortizohen. Për Kontratën lot 1 dhe lot 2, janë parashikuar 3 automjete Tip A, 1 automjet Tip B dhe 1 automjet Tip C, ndërsa për lot 3, janë parashikuar 4 automjete Tip A, 3 automjete Tip B, 4 automjete Tip C dhe 1 automjet Tip D. Bazuar në pagesat e realizuara sipas zërit të mësipërm, si pasojë e parashikimit të pa argumentuar në preventivin origjinal të punimeve, për këtë segment është shpenzuar më tepër vlera 92,000 USD (1 automjet Tip A x 15,000 USD + 2 automjete Tip B x 13,000 USD + 3 automjete Tip C x 12,000 USD + 1 automjet Tip D x 15,000 USD). Duke qenë se dorëzimi i automjeteve në përfundim të kontratës shoqërohet me amortizim të tyre (sidomos për faktin e shtyrjes së afatit të përfundimit), **vlera 110,000 USD (92,000 USD +TVSH), përbën rritje të pa argumentuar të kostos së projektit dhe konsiderohet shpenzim pa efektivitet për projektin**(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 37-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 -Rekomandimi:** - ARRSH të marrë masa për monitorimin e projekt-zbatimeve dhe preventivave përkatës për projekte në proces dhe ato që do hartohen në të ardhmen, në mënyrë që të shmangen kostot e pa nevojshme dhe jo efektive në realizimin e projekteve. Ky furnizim prej 12 automjete duhet të reduktohet, duke i kaluar ato në administrim të ARRSH. Në rast mos reagimi, vlera e furnizimit të tyre do të konsiderohet dëm ekonomik.

*Vazhdimisht*

**3.2-Rekomandimi:-** Njësia e Menaxhimit të Projektit, në kushtet e pezullimit të punimeve, në mënyrë që të shmangë amortizimin e mëtejshëm të automjeteve të cilat dorëzohen në përfundim të Kontratës si dhe kostove për mbajtjen në aktivitet të tyre, t'i kërkojë kontraktorit dorëzimin e menjëhershëm të automjeteve të pa nevojshme në dispozicion të Mbikëqyrësit të Punimeve dhe tyre pranë ARRSH.

*Brenda datë 31.03.2020*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimit u konstatua se për lotin e 3 zgjatja e afatit për PMU sipas amendimeve të kontratës me konsulentin nuk është në proporcion të drejtë me kontratën fillestare por kemi një zgjatje të afatit të funksionimit të PMU me 11 muaj më tepër, duke sjellë një rritje të kostove për këtë projekt me vlerë 33,000 USD (11 muaj x 3,000 USD) (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 22-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1-Rekomandimi:-** Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrin masa që në të ardhmen gjatë procesit të miratimit të zgjatjeve të afatit për kontratat, të rishikojnë dhe të rakordojnë në përputhje me kontratën bazë dhe termat e referencës, duke shmangur shtimin e afateve përtej kushteve të miratuara për një përdorim sa më eficient të fondeve të akorduara.

## **D. MASA DISIPLINORE**

Bazuar në kontratën individuale të punës nr. 10600 prot., datë 23.11.2018, neni 9, pika 9.5-9.11, neni 10, pika 10.3, si dhe Aneksi A "Termet e referencës", kërkojmë nga Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH të vlerësojë performancën e punës dhe të kërkojë miratimin e Bankës Islamikë për Zhvillim, për fillimin e procedurave për dhënie masë disiplinore, si më poshtë:

## **Nga “Vërejtje me shkrim” deri “Largim nga detyra”**

- Për z. B.M, në cilësinë e Drejtorit të Njësisë së Menaxhimit të Projektit lot 1 dhe lot 2.

### **E. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR**

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “Largim nga puna”, për:

**z. H.L, në cilësinë e Ish-Drejtorit të Projektit.**

**z. A.Q, në cilësinë e Ish-Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH.**

### **F. SHËNIM I KRYETARIT**

Pavarësisht përpjekjeve të grupit të auditimit, ky auditim rezulton me rekomandime të adresuara jo mjaftueshëm në raport me gjetjet dhe në disa raste me një auditim të ulët të punimeve të realizuara.

Ky projekt do të auditohet përsëri përgjatë vitit 2020 lidhur me këtë periudhë aktiviteti të projektit. Kjo për faktin se problemi i reduktimit të pagesave, vonesave të shkaktuara si nga ana e ARSH ashtu edhe vetë kontraktorëve, miratimi i urdhër ndryshimeve dhe problematikave të tjera janë në fazën e shqyrtimit nga Bordi i Diskutimit, të cilat ndikojnë në rezultatin e auditimit, favorizon që adresimi i shumë problematikave nga auditimi nuk mund të bëhet në këtë fazë të zbatimit të projektit, pra të realizimit të kontratave por pas vendimmarrjeve përkatëse.

Për sa më sipër ky projekt do të auditohet përsëri gjatë vitit 2020 dhe kjo periudhë do të riauditohet.

Për vonesat në zbatimin e këtij projekti (pasi nga afati i përfundimit i parashikuar në vitin 2018, deri tani është realizuar 60 % e disbursimeve), si dhe gjithë mangësitë e konstatuara (të cilat shpjegohen në opinionin e auditimit dhe këtë Vendim dhe Raport), ky vendim dhe raporti përkatës do t'i përcillen për dijeni e veprime edhe Kryeministrit, Zv/Kryeministrit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja.

**Bujar LESKAJ**

## **KRYETAR**